



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 gusht 2017
Nr. ref.:RK 1118/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI36/17

Parashtrues

Bashkim Berisha

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Rev. nr. 358/2016, të 16 janarit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gérxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Bashkim Berisha nga fshati Prugoc, komuna e Prishtinës (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi), i cili përfaqësohet nga avokati Fatlum Podvorica.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 358/2016] e Gjykatës Supreme, të 16 janarit 2017.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të garantuara me nenin 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 31 mars 2017, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).
6. Më 7 prill 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Altay Suroy gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtares, të përbërë nga gjyqtarët: Almiro Rodrigues (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.
7. Më 28 prill 2017, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 5 korrik 2017, Kolegji shqyrtares e shqyrtoi raportin e gjyqtarit rapportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmëri.

Përbledhja e fakteve

9. Më 7 dhjetor 2010, ndodhi një aksident i komunikacionit në të cilin parashtruesi pësoi lëndime trupore.
10. Parashtruesi paraqiti padinë në Gjykatën Themelore në Prishtinë kundër Kompanisë së Sigurimeve “Illyria” (në tekstin e mëtejmë: Sigurimi “Illyria”) për kompensimin e dëmit material dhe jomaterial.
11. Më 29 janar 2014, Sigurimi i paditur “Illyria” në përgjigjen në padinë e parashtruesit nuk e kontestoi bazën ligjore të kërkesëpadisë, por propozoi që të merret një aktgjykim i pranueshëm.
12. Më 25 maj 2014, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin [C. nr. 616/11] me të cilin e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e parashtruesit dhe e urdhëroi

Sigurimin “Illyria” që t’ia paguajë parashtruesit shumën e caktuar monetare si kompensim pér dëmin material dhe jomaterial.

13. Në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore thuhet: “*Gjykata me rastin e caktimit të lartësisë pér secilën formë të shpërblimit të dëmit, jomaterial dhe material, ka vendosur duke marrë pér bazë mendimin e ekspertëve mjekësor. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se shumat e gjykuara paraqesin si shpërblim real dhe të drejtë me të cilat paditësi do t’i plotësoi nevojat dhe të mirat e dëmtuar që përndryshe paraqesin si shpërblim absolut të dëmit që ju ka shkaktuar*”.
14. Kundër Aktgjykimit [C. nr. 616/11] të Gjykatës Themelore, i padituri Sigurimi “Illyria” paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit pér shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
15. Më 14 shtator 2016, Gjykata e Apelit nxori Aktgjykimin [Ac. nr. 4270/14] me të cilin e pranoi pjesërisht ankesën e të paditurit Sigurimi “Illyria”, dhe kështu e zvogëloj shumën e caktuar të kompensimit pér dëmin material dhe jomaterial. Në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit thuhet:

“*Gjykata e Apelit gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike pér pjesën e vërtetuar të aktgjykimit, ndërsa pér pjesën tjetër aktgjykimi është dashur të ndryshohet pér shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale ...*”.

16. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit kërkesën pér revizion në Gjykatën Supreme e paraqitën njëkohësisht, parashtruesi dhe Sigurimi “Illyria” dhe atë pér shkak të vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.
17. Më 16 janar 2017, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin [Rev. nr. 358/2016] me të cilin e refuzoi kërkesën pér revizion të parashtruesit si të pabazuar, ndërsa kërkesën pér revizion të Sigurimit “Illyria” e pranoi pjesërisht dhe e zvogëloj shumën monetare pér kompensimin material.
18. Në arsyetimin e Aktgjykimit thuhet:

“*Objekt shqyrtimi në Gjykatën Supreme ishin pretendimet nga revizioni i paditësit (parashtruesit), sipas të cilave, me rastin e zvogëlimit të shumës së kompensimit të gjykuar nga gjykata e shkallës së parë, nga ana e gjykatës së shkallës së dytë gabimisht është zbatuar e drejta materiale, mirëpo Gjykata Supreme gjeti se pretendimet e tillë të paditësit janë të pabazuara*”.

“*Gjykata Supreme e ka pranuar pjesërisht si të bazuar kërkesën pér revizion e të paditurës (Sigurimi “Illyria”) dhe i zvogëloj shumat monetare [...] Gjykata vlerëson se duke marrë parasysh kriteret e lartpërmendura pér shpërblimin e dëmit jomaterial të shkaktuar në aksident komunikacioni si dhe praktikën gjyqësore të gjertanishme, edhe shumat e gjykuara nga gjykata e shkallës së dytë në emër të kompensimit pér*

dhimbje fizike, frikë dhe zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor janë të larta dhe në kundërshtim me kriteret e lartpërmendura.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi pretendon “se ka pasur shkelje të nenit 31 E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm të Kushtetutës së Republikës së Kosovës lidhur me paragrin 1 të nenit 6 E Drejta për Proces të Rregullt të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe nenit 21 Parimet e Përgjithshme, ... sepse me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimin e gabuar të dispozitave ligjore nga Gjkata e Apelit dhe Gjkata Supreme atij i është zvogëluar kompensimi monetar”.
20. Parashtruesi kërkon nga Gjkata “të deklaron të pavlefshme Aktgjykimin e Gjkatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 358/2016 të datës 16.01.2017 dhe Aktgjykimin e Gjkatës së Apelit të Kosovës AC. nr. 4270/14 të datës 14.09.2016 dhe ta kthen rastin në rishqyrtim”.

Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjkata së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të parashikuara më tej me Rregullore të punës.
22. Në këtë kuptim, Gjkata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 (Juridikioni dhe Palët e Autorizuara) të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. *Gjkata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*
(...)
7. *Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*
23. Gjkata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; kërkesa është parashtruar në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit dhe parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike.
24. Megjithatë, Gjkata i referohet edhe nenit 48 të Ligjit [Saktësimi i kërkesës], i cili thotë:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”
25. Gjkata, më tej, i referohet rregullit 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës, i cili parashikon:

“(1) *Gjkata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:*
[...]

d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

b) faktet e paraqitura në asnje mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese”.

26. Në thelb, Gjykata vëren se parashtruesi konsideron se gjykatat i kanë shkelur të drejtat e tij nga neni 31 i Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ, sepse në vendimet e tyre e kanë vërtetuar gabimisht gjendjen faktike dhe zbatuar gabimisht të drejtën materiale, gjë që ka ndikuar në zvogëlimin e shumës monetare të kompensimit për dëmin material dhe jomaterial për të cilin ai konsideron se ka të drejta në atë formë në të cilën i është caktuar me vendimin e Gjykatës Themelore.
27. Në këtë kuptim, Gjykata përsërit se Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejmë: GJEDNJ) ka përcaktuar se “*është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale*” (shih, *mutatis mutandis*, *García Ruiz kundër Spanjës* [GC], nr. 30544/96, paragrafi 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).
28. Gjykata, gjithashtu, rithekson se vërtetimi i plotë i gjendjes faktike është në juridiksionin e plotë të gjykatave të rregullta dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm të sigurojë respektimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe me instrumentet e tjera ligjore, prandaj ajo nuk mund të veprojë si gjykatë e “shkallës së katërt” (shih, GJEDNJ, rasti *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, të 16 shtatorit 1996, paragrafi 65; shih, po ashtu, *mutatis mutandis*, Gjykata Kushtetuese rasti KI86/11, parashtruesi i kërkesës: *Milaim Berisha*, i 5 prillit 2012).
29. Në bazë të kësaj, Gjykata gjen se pretendimet e parashtruesit për zbatimin e gabuar dhe interpretimin jokonsistent të dispozitive relevante ligjore, si dhe pretendimet për vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta ngrehin çështje të cilat bien në fushëveprimin e gjykatave të rregullta (ligjshmëria), dhe jo në domenin e Gjykatës Kushtetuese (kushtetutshmëria).
30. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të shqyrtojë nëse, eventualisht, janë shkelur ose neglizhuar të drejtat kushtetuese (*e drejta për gjykim të drejtë, e drejta për qasje në gjykatë, e drejta për mjete efektive juridike, etj.*), si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë, eventualisht, arbitrar ose diskriminues.
31. Prandaj, kjo Gjykatë do të lëshohet përjashtimisht në shqyrtimin e mënyrës në të cilën gjykatat kompetente i kanë vërtetuar faktet dhe zbatuar rregulloret pozitive juridike mbi faktet e vërtetuara në këtë mënyrë, atëherë kur është evidente se në një procedurë të caktuar ka ekzistuar mënyra arbitrale e veprimit të gjykatës së rregullt, si në procedurën e vërtetimit të fakteve, ashtu edhe në procedurën e zbatimit të rregulloreve relevante pozitive juridike.

32. Megjithatë, Gjykata vëren se parashtruesi në kërkesën e tij në Gjykatë i ka ngritur çështjet e njëjtë që lidhen me lëshimet procedurale të cilat pretendohet të jenë bërë nga Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes për ankesën e të paditurit, respektivisht Sigurimit “Illyria”.
33. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se kundërshtimet identike parashtruesi i ka paraqitur edhe në Gjykatën Supreme, e cila në Aktgjykimin e saj [Rev. nr. 358/2016] është marrë hollësish me të njëjtat dhe i ka vlerësuar këto pretendime si të pabazuara, me arsyetimin i cili kësaj Gjykate nuk i duket arbitrar.
34. Për më tepër, Gjykata vëren se Gjykata Supreme gjithashtu i ka shqyrtauar edhe pretendimet e tjera të cilat lidheshin me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, dhe se kjo, sipas pretendimeve të parashtruesve “*ka ndikuar që Gjykata e Apelit ta zvogëlojë shumën monetare të kompensimit*”. Megjithatë, edhe këto pretendime janë gjetur të pabazuara nga Gjykata Supreme.
35. Më tej, Gjykata nuk e gjen arbitrar as Aktgjykimin [Rev. nr. 358/2016] e Gjykatës Supreme, për arsyen se Gjykata Supreme për të gjitha vendimet e saj ka dhënë shpjegime të qarta të cilat kanë bazë ligjore, si në aspektin e bazës për refuzimin e kërkesës për revizion të parashtruesit, ashtu edhe në aspektin e pranimit të pjesshëm të kërkesës për revizion e të paditurit.
36. Duke pasur parasysh të cekurat, si dhe rrethanat e lëndës konkrete, Gjykata në arsyetimin e vendimeve të kontestuara nuk sheh ndonjë arbitraritet në zbatimin e të drejtës materiale. Gjithashtu, nuk mund të gjejë as elementet që do të kishin treguar për parregullsinë ose arbitraritetin në marrjen e vendimeve të kontestuara në dëm të parashtruesit.
37. Rrjedhimisht, Gjykata konsideron se asgjë në këtë rast të prezantuar nga parashtruesi nuk tregon se procedurat në gjykatat e rregullta ishin të padrejta ose arbitrarë në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të jetë e bindur se thelbi i së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm ishte shkelur, apo se parashtruesit të kërkesës i janë mohuar garancitë procedurale, gjë që do të kishte rezultuar me shkeljen e kësaj të drejte sipas nenit 31 të Kushtetutës ose paragrafit 1 të nenit 6 të KEDNJ-së.
38. Gjykata konsideron se është obligim i parashtruesit të kërkesës t'i mbështesë pretendimet e tij kushtetuese dhe të paraqesë prova *prima facie* që tregojnë për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ. Ky vlerësim është në përputhje me juridikcionin e Gjykatës (shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese, nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtruesit e kërkesës: *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla*, të 5 dhjetorit 2013).
39. Megjithatë, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk e ka dëshmuan pretendimin e tij dhe as nuk ka treguar se ka pasur shkelje të të drejtave të tij.
40. Gjykata, më tej, konsideron se nuk mund të veprojë si “gjykatë e shkallës së katërt”.

41. Prandaj, kërkesa e parashtruesit është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me rregullin 36 (1) d) dhe (2) b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 47 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 5 korrik 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari rapportues

Altay Suroy

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

